

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Akuzat e opozitës, ministrja Spahiu pret në zyrë qytetarin: Rastin e Albi Sulës do ta ndjekim në Turqi! Mo s bëni politikë me shëndetin e tij
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/akuzat-e-opozites-ministrja-spahiu-pret-ne-zyre-qytetarin-rastin-e-albi-i401889
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:54:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 09:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	258796d0ab1e1ba631b715b5ff5fbf8e89efe2651da231762b555e6b05255ec1
TEKSTI	6dcfc2d18338d9a814881320ca254e4f7cdaca9d28a82da2573a832db495a652
PAMJA	52f67e1a7e08895e2692f3be6bb1dc6198a50f1e69840292741c4f7341721acf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b4b2120d3adbb192361a557cadebea1465764837f1762a18ec74cfadac6e1d04
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b4b2120d3adbb192361a557cadebea1465764837f1762a18ec74cfadac6e1d04

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Politikë

23 Shtator 2026, 11:39

Akuzat e opozitës, ministrja Spahiu pret në zyrë qytetarin: Rastin e Albi Sulës do ta ndjekim në Turqi! Mos bëni politikë me shëndetin e tij

Shkruar nga Newsbomb



Ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu

Ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu ka reaguar në lidhje me deklaratat se qytetari Albi Sula nuk ka marrë mjekimin në Spitalin Onkologjik. Ishte zëdhënësjja e Antikorrupsionit në PD, Genta Vangjeli e cila në një deklaratë nga selia e PD-së hodhi akuzat se Sula nuk ka marrë një përgjigje të qartë për burimin e problemit të tij shëndetësor dhe se pas një operacioni onkologjik, nuk ka marrë asistencë nga mjekët.

"Vetëm një ditë pas emërimit të ministres së re të Shëndetësisë, një nënë pensioniste u detyrua të shtrihej në tokë para Ministrisë së Shëndetësisë, për të kërkuar ndihmë për djalin e saj 30-vjeçar, Albi Sulën, i sëmurë dhe i papunë. Albi prej tre vitesh përballët me dhimbje të forta dhe, sipas dëshmisë së tij dhe familjes, pas vizitave, analizave dhe trajtimeve në Shqipëri ende nuk ka marrë një përgjigje të qartë për burimin e problemit të tij shëndetësor. Pasi i është nënshtruar një operacioni onkologjik pranë QSUNT, ky pacient deklaron se nuk ka marrë më asistencë nga bluzat e bardha.

Në këto kushte, ka kërkuar që shteti ta dërgojë në Turqi dhe pas refuzimit, vetë familja e ka dërguar për një ndihmë të specializuar në Turqi nga ku është kthyer me porositë që të vijojë të kryejë kontrole periodike për të mbajtur sëmundjen nën kontroll. Pasi Albi ka rikërkuar ndihmën e shtetit e konkretisht MSH për të mundësuar kontrollet periodike në Turqi për shkak të pamundësisë ekonomike për të paguar vetë, edhe njëherë tjetër Ministria nuk bën asgjë...", thuhet në deklaratën e Vangjelit.

Revista



Abonohu tani dhe lexojë

Lajmet e fundit



Bota

Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Aktualitet

GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSËT në Rusi i shumëkërkuan Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdani pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)

Zbulohet më shumë artikuj

Në lidhje me këto pretendime, Spahiu ka publikuar një foto ku shfaqet Sula së bashku me nënën e tij në zyrën e saj në Ministrinë e Shëndetësisë.

Në një postim në Facebook, ministri bëri me dije se e ka dëgjuar me vëmendje për problematikën e tij shëndetësore dhe rrugëtimin e vështirë të trajtimit. Sipas saj, Sula është trajtuar dhe ndjekur nga mjekët e Spitalit Onkologjik në QSUT dhe rasti i tij është referuar për ndjekje të mëtejshme në Turqi.

Ndërsa po ashtu, nënvizon në postimin e saj se një problem shëndetësor nuk duhet të kthehet në mjet për të ndërtuar një akuzë që nuk përputhet me faktet, ku në mes qytetari dhe halli i tij.

“Dyert e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë dhe do të mbeten të hapura. Për të dëgjuar, për të sqaruar dhe, aty ku është e mundur, për të gjetur zgjidhje”, shkruan ajo.

Postimi i plotë:

Qytetari në foto është Albi Sula. Së bashku me nënën e tij, e prita dhe personalisht në zyrën time.

E dëgjova me vëmendje për problematikën e tij shëndetësore dhe rrugëtimin e vështirë të trajtimit. Sqaruam hap pas hapi ndjekjen e rastit nga strukturat shëndetësore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si edhe hapat që do të vijojnë.

Përballë disa pretendimeve të bëra publikisht nga opozita, faktet janë të qarta:

- Qytetari për të cilin pretendohet se nuk është pritur, ka qenë dhe në zyrën time, përballë meje dhe nënës së tij.
- Ai është trajtuar dhe ndjekur nga mjekët e Spitalit Onkologjik në QSUT, sipas nevojave dhe protokolleve mjekësore.
- Në zbatim të procedurave administrative dhe kontratës me spitalin përkatës, rasti i tij është referuar për ndjekje të mëtejshme në Turqi.

Të bësh politikë është legjitime. Të kritikosh është e drejtë. Por një problem shëndetësor nuk duhet të kthehet në mjet për të ndërtuar një akuzë që nuk përputhet me faktet.

Për mua, përpara çdo debati politik është qytetari dhe halli i tij.

Dyert e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë dhe do të mbeten të hapura. Për të dëgjuar, për të sqaruar dhe, aty ku është e mundur, për të gjetur zgjidhje.

Sepse #PraniBesnike nuk është slogan. Është përgjegjësi ndaj qytetarit.


Ky postim i Facebook nuk është më i disponueshëm. Ai mund të jetë hequr ose parametrat e privatësisë së postimit mund të jenë ndryshuar.


Qendra e ndihmës 

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Mërkurë 20:16 Newsbomb

"Shteti i gysrave!" Salianji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGMI)



Politikë

PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Vlora Hysenin


🕒 E Mërkurë 19:44 Newsbomb



Politikë

Klodiana Lala paralajmëron nga zyra e Fevziut: Mbaje shënim, do dalin të dhëna që s'i kishte imagjinuar ndonjëherë

🕒 E Mërkurë 14:08



🕒 E Mërkurë 13:35

Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe më shumë mundësi nga fondet e BE-së



Politikë



Politikë

Ish-kreu i SPAK ia firmosi masat e sigurisë, gazetari jep detaje: Vlorë Hyseni pinte kafe njëherë në javë me Altin Dumanin...

E Mërkurë 13:08

"Ka rënë shteti, Kuvendi flet për s*ksin e engjëjve", përplasje të "ligjet" pas skandalit me SHISH-in, demokratët kërkojnë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë

E Mërkurë 11:06



E Mërkurë 10:08

Një ditë pas goditjes së SPAK ndaj SHISH-it, demokratët mbledhen në seli, Berisha thërret Kryesinë e re



Politikë

Balla dhe Tarquinio dalin me DEKLARATË për takimin dyditor për anëtarësimin në BE: Gati deri në fund të 2027

E Martë 17:08 Newsbomb



Politikë

"Edi Rama të kthehet nga Amerika dhe të japë dorëheqjen", Erald Kapri kërkon që vendi të shkojë në zgjedhje: Sot shteti ka rënë, jemi turpëruar!

E Martë 15:27



E Martë 13:25

Besmir Veli: Histori, kulturë, tradita, kulinari, natyrë...i gjeni të gjitha këtu në Delvinë



Politikë

Kthimi i Edi Ramës nga Amerika,
Flamur Noka thirrje SPAK pas akuzave
për shefin e SHISH dhe Ilir Prodën:
Priteni në aeroport dhe çlironi vendin!

🕒 E Martë 13:12



Politikë

Sali Berisha flet për takimet e Vlora
Hysenit dhe Ergys Agasit: Darkonin te
restoranti pranë shtëpisë time, i bëj
thirrje FBI-së ta arrestojë

🕒 E Martë 12:31

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.